



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT

Nr. 2552 Prot.

Tiranë, më 17.05. 2023

Lënda: Monitorimi i 4-mujorit të parë të buxhetit për vitin 2023.

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Tiranë

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 85/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, mbështetur në udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr. 22, datë, 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, udhëzimin plotësues nr. 2, datë 19.1.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, po ju paraqesim, “Monitorimi i 4-mujorit të parë të buxhetit për vitin 2022”, po ju dërgojmë të dhënat mbi:

- Shpenzimet e realizuara për 4-mujorin e parë të buxhetit për vitin 2023 për të gjitha zërat buxhetor, duke përfshirë dhe institucionet e varësisë, rakorduar dhe me thesarin;
- Numrin e analizave/inspektimeve etj., të realizuara për periudhën janar- prill 2023;
- Realizimi i zërave buxhetor për 4-mujorin e parë përshkruar me shifra dhe në mënyrë narrative.

a) REALIZIMI I BUXHETIT 4- MUJORI I PARË 2023

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për vitin 2023 i janë akorduar fondet buxhetore n, sipas 13 njësive shpenzuese, dhe konkretisht :

- Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit
- Drejtoria Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Berat
- Drejtoria Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Dibër
- Drejtoria Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Durrës
- Drejtoria Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Elbasan
- Drejtoria Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Fier
- Drejtoria Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Gjirokastrë

- Drejtoria Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Korçë
- Drejtoria Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Kukës
- Drejtoria Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Lezhë
- Drejtoria Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Shkodër
- Drejtoria Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë
- Drejtoria Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Vlorë

të cilat administrojnë buxhet më vete për shpenzimet korrente (*paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative*), dhe për sa i përket shpenzimeve kapitale (*investimet*) ato janë të përqendruara në organin qendror në Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit .

Në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kuadrin normativ si edhe nevojat e institucionit, janë menaxhuar me efikasitet fondet buxhetore të akorduara për Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

Realizimi i zërave të buxhetit në 4-mujorin e parë 2023 është 24 %, themi që është një rezultat i kënaqshëm.

Fondet e Akorduara dhe të Realizuara 4/mujorin e parë 2023:

Llogaria Ekonomike	Buxheti fillestar	Ndryshimet gjate vitit		Buxheti total plan viti 2023	Realizimi i Buxhetit (2022)	Realizimi (%)
		Shtesa	Pakësime			
600	376,450,000			376,450,000	112,704,799	30%
601	63,800,000			63,800,000	18,786,901	29%
602	142,000,000			142,000,000	32,601,538	23%
606	0	1,400,000		1,400,000	100,000	7%
231	0	101,155,000		101,155,000	0	0
Totali	582,250,000	102,555,000	0	684,805,000	164,193,238	24%

Realizimet për shpenzimet korrente në kodin 90502AG “Inspektimi dhe menaxhimi i riskut në fushën e sigurisë ushqimore” janë në masën 24 %, shpenzimet paga + sigurime (600+601), shpenzime korrente (602) dhe Fond i veçantë (606).

Investimet e brendshme për periudhën Janar-Prill 2023 sipas projekteve paraqitet si më poshtë:

- Kodin 18AJ402 “Pajisje specifike për grupin e inspektimit” në vlerë 45.000.000 lekë nga ASHPP me e-mail se procedura është anuluar dhe jemi në pritje të njoftimit të anulimit me shkresë zyrtare. Procedura është hedhur në regjistrin e parashikimeve të vitit 2023 dhe është miratuar nga APP-ja.

- Kodin M051467 “Pajisje Laboratorike” në vlerë 56.155.000lekë, procedura ndiqet nga ASHPP, jemi pritje të njoftimit të fituesit.

Realizimi i investimeve për 4/mujorin e parë është 0 %,

Duke monitoruar të 13 njësitë shpenzuese të Autoriteti Kombëtar të Ushqimit, realizimi i buxhetit 4-mujor paraqitet si më poshtë, të dhënat janë të rakorduara dhe me degët e Thesarit:

Realizimi i zerave buxhetor 4/mujori i parë 2023

NR	Kodi Institucionit	Emri institucionit	Investime Llogaria 231		Paga Llogaria. 600		Sig.Shoq Llogaria. 601		Shp.operative Llogaria.602		Llogaria. 606		TOTALI I BUXHETIT	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	1005118	AKU Qendrore	101,155,000	-	116,600,000	33,957,286	19,900,000	5,644,645	68,000,000	15,210,279	1,340,000	100,000	306,995,000	54,912,210
2	1005119	Drejtoria Rajonale Berat			16,000,000	4,331,884	2,700,000	711,547	5,000,000	965,260	-	-	23,700,000	6,008,691
3	1005120	Drejtoria Rajonale Diber			14,000,000	3,910,070	2,400,000	656,812	3,500,000	539,478	-	-	19,900,000	5,106,360
4	1005121	Drejtoria Rajonale Durres			24,200,000	7,385,171	4,100,000	1,233,321	11,000,000	4,324,132	-	-	39,300,000	12,942,624
5	1005122	Drejtoria Rajonale Elbasan			19,000,000	6,071,831	3,200,000	1,013,990	4,000,000	815,816	-	-	26,200,000	7,901,637
6	1005123	Drejtoria Rajonale Fier			19,000,000	5,085,574	3,200,000	849,292	5,500,000	743,525	-	-	27,700,000	6,678,391
7	1005124	Drejtoria Rajonale Gjirokaster			19,000,000	6,154,122	3,200,000	1,027,738	6,000,000	876,024	-	-	28,200,000	8,057,884
8	1005125	Drejtoria Rajonale Korce			30,000,000	8,848,705	5,000,000	1,477,821	7,000,000	1,470,101	-	-	42,000,000	11,796,627
9	1005126	Drejtoria Rajonale Kukës			16,000,000	4,453,619	2,700,000	743,455	6,000,000	905,083	-	-	24,700,000	6,102,157
10	1005127	Drejtoria Rajonale Lezhe			13,650,000	4,510,586	2,300,000	752,956	6,000,000	831,288	-	-	21,950,000	6,094,830
11	1005128	Drejtoria Rajonale Shkoder			20,000,000	5,640,679	3,400,000	941,993	6,000,000	1,704,039	-	-	29,400,000	8,286,711
12	1005129	Drejtoria Rajonale Tirane			46,000,000	14,981,439	7,800,000	2,501,901	9,000,000	3,302,808	60,000	-	62,860,000	20,786,148
13	1005130	Drejtoria Rajonale Vlore			23,000,000	7,373,833	3,900,000	1,231,430	5,000,000	913,705	-	-	31,900,000	9,518,968
TOTALI			0	0	376,450,000	112,704,799	63,800,000	18,786,901	142,000,000	32,601,538	1,400,000	100,000	684,805,000	164,193,238

b) REALIZIMI I INSPEKTIMEVE DHE ANALIZAVE 4- MUJORI I PARË 2023

1. Për periudhën e 4-mujorit të parë 2023 janë kryer gjithsej **30,873** inspektime nga sektorët KUUKOBU, MBIB dhe PIK

Janë marrë masa administrative si më poshtë:

- **1391** Paralajmërimë
- **146** Gjopa
- **11** Ndërprejje aktiviteti

SEKTORI	Janar – Prill 2023			
	Nr. i inspektimeve	Gjoha (nr)	Paralajmërimet (nr)	Ndërprerje aktiviteti (nr)
I Kontrollit Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe OB Ushqimor	8684	143	1379	11
Mbrojtje e Bimëve dhe Imputeve Bujqësore	1415	3	12	0
Pikat e Inspektimit Kufitar	20774	0	0	0
Total	30873	146	1391	11

Inspektimet e planifikuara dhe realizuara sipas Planit Vjetor për vitin 2023 në 4- mujin e parë 2023, paraqiten si me poshtë:

QARKU	Inspektimet të planifikuara në planin vjetor të inspektimeve 2023	Realizimi i inspektimeve Janar - Prill 2023			% Realizimit nga Inspektimet e programuara	% Realizimit të inspektimeve të paprogramuara
		Inspektimet të Realizuara gjithsej	Nga keto			
			Inspektimet të programuara	Inspektimet të pa programuara		
TIRANË	2122	2463	2080	383	98%	18%
DURRËS	1024	1142	994	148	97%	14%
BERAT	587	509	424	85	72%	14%
SHKODËR	869	741	698	43	80%	5%
VLOREË	773	780	691	89	89%	12%
FIER	1056	981	893	88	85%	8%
DIBËR	299	322	274	48	92%	16%
ELBASAN	840	905	765	140	91%	17%
KORÇË	759	802	658	144	87%	19%
LEZHA	538	614	531	83	99%	15%
GJIROKASTËR	564	548	517	31	92%	5%
KUKËS	265	292	237	55	89%	21%
TOTALI	9696	10099	8762	1337	90%	14%

Për periudhën **Janar-Prill 2023** rezultojnë se në rang kombëtar janë realizuar ***gjithsej 10.099 inspektime*** (kundrejt ***9.696 inspektime të planifikuara të deklaruar nga DRAKU***) nga të cilat ***8762 inspektime*** janë realizuar në kuadër të planit vjetor të kontrolleve zyrtare me bazë rishikim miratuar nga Ministri dhe ***1337 inspektime*** jashtë programit në kuadër të licencimeve, miratimin e subjekteve të reja, indicet, njoftimin nga sistemi RASFF, ri kontrollimet mbi verifikimin e detyrave të lëna, etj.

2. Për periudhën e 4-mujorit të parë 2023 janë kryer **5,006** analiza nga Laboratori Fiziko -Kimik , Laboratori Mikrobiologjik, Laboratori i Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve , Laboratori i Mbrojtjes së Bimëve. Numri i analizave dhe mostrave i detajuar paraqitet si më poshtë:

Janar- Prill 2023	Shërbimet Laboratorike								Origjina e Mostrave			Total		Jokonfo rmiteti	Problematika
	Fiziko-Kimike		Mikrobiologjike		Shëndeti i Kafshëve		Mbrojtje e Bimëve		Kontroll Zyrtar në:		Autokon troll				
	Mostra	Analiza	Mostra	Analiza	Mostra	Analiza	Mostra	Analiza	PIK	Terren		Mostra	Analiza		
Tiranë	289	641	106	106	0	0	0	0	10	385	0	395	747	0	
Durrës	387	1026	85	98	0	0	35	36	277	230	0	507	1160	7	Në thyerza jeshile evidentohet rrezikua e...
Shkodër	134	378	142	177	0	0	0	0	39	237	0	276	555	0	
Fier	209	457	171	220	0	0	0	0	0	380	0	380	677	0	
Vlorë	67	203	46	56	0	0	0	0	21	92	0	113	259	0	
Gjirokastrë	229	630	187	241	0	0	0	0	128	288	0	416	871	0	
Korçë	319	557	106	136	39	39	5	5	232	198	39	469	737	36	Masit Stafilokok
TOTAL	1634	3892	843	1034	39	39	40	41	707	1810	39	2556	5006	43	*përjashto monitorimin e qumështit lëndë e parë

Të dhënat mbi origjinën e mostrave

- 27.6% janë nga kontrollet zyrtare në Pikat e Inspektimit Kufitar;
- 70.8% nga kontrollet zyrtare në terren;
- 1.6 % të rasteve për analiza vetëkontrolli.

Për periudhën e 4-mujorit të parë 2023 janë marre 561 mostra dhe janë kryer 1.122 analiza ne kuadër te monitorimit të qumështit.

Laboratori	Monitorim qumështi		Rezultati mbi normë referuar udhëzimit nr. 5, datë 25.3.2011		
	Nr.		Qumësht lope		Qumësht dhie
	Mostra	Analiza	NPM ≤ 100.000	QS ≤ 400.000	NPM ≤ 1.500.000
Tiranë	68	136	47	0	0
Durrës	33	66	7	0	0
Shkodër	201	402	47	0	0
Fier	154	308	24	0	0
Vlorë	21	42	7	0	0
Gjirokastrë	13	26	3	0	0
Korçë	71	142	70	7	0
TOTAL	561	1122	205	7	0

c) REALIZIM I BUXHETIT 4-MUJOR TË PARË 2023 SIPAS LLOGARIVE

Realizimi i zërave buxhetor sipas llogarive për 4-mujorin e parë të vitit 2022 paraqitet si më poshtë:

Realizimi i zërave Buxhetor 4-mujori i pare 2023

Llogaria Ekonomike	Buxheti total plan viti 2022	Realizimi i Buxhetit (2022)	Realizimi (%)
600	376,450,000	112,704,799	30%
601	63,800,000	18,786,901	29%
602	142,000,000	32,601,538	23%
606	1,400,000	100,000	7%
231	101,155,000	0	0
Totali	684,805,000	164,193,238	24%

- Realizimi i buxhetit 4-mujor 2022 në llogarinë 600 dhe 601** është në masën 30% , si rezultat i vendeve vakant në stafin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, nga 433 punonjës me strukturë numri mesatar i punonjësve është 417 , si dhe janë paguar dhe 10 punonjës me kontratë në periudhën Janar- Prill 2023.
- Realizimi i buxhetit 4-mujor llogaria 602** është në masën 23%, janë bërë likuidimet në lidhje me shërbimet bazë të institucionit siç janë
 - “Shërbime nga të tretë” të cilat janë në vlerën **11.782.471 lekë** ku përfshihen pagesat për shërbimet si Energji elektrike, Ujë, Shërbim postar, Shërbim i sigurimit dhe ruajtjes së objekteve, Internet dhe Shërbime të tjera ku vlerën më të madhe në këtë shërbim e zënë analizat e kryera, etj.
 - “Shpenzime për qiramarrje” në vlerën **5.940.874leke** janë pagesat e qirasë për zyrat e inspektorëve veterinerë në pikat doganore dhe për ambiente me qira për Drejtorinë e Përgjithshme.
 - “Shpenzime transporti” në vlerën **3.684.548lekë** janë pagesat për shpenzimet e sigurimit të mjeteve të transportit, taksa, kolaudim, etj., të cilat janë bërë gjatë 4/mujorit të parë 2023. Shpenzime të cilat janë bazë për funksionimin e mjeteve të institucioneve të AKU-së.
 - “Materiale dhe Shërbime të Përgjithshme” në vlerën **2.889.832lekë**, janë pagesa Kancelari, Materiale pastrim dezinfektim, Toner, në disa Drejtori Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit janë bërë prokurimet për këto zëra.
 - “Shpenzime të tjera operative” në vlerën **1.317.546lekë**, janë pagesa për detyrime gjyqësore, shpenzime për honorarë, etj.
 - “Shpenzime udhëtimi” në vlerën **1.909.587lekë** në këtë zë përfshihen pagesat për “Shpenzime udhëtim e dieta brenda vendit” ,shpenzimet që të gjithë institucionet e

varësisë kryejnë për pagesën e dietave të punonjësve të tyre që largohen me punë jashtë vendbanimit të tyre. *Shpenzime udhëtim e dieta jashtë shtetit*” përfshihen udhëtimet e punonjësve për trajnime dhe pjesëmarrje në work-shope, konferenca jashtë vendit.

- “*Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale*” në vlerën **1.643.200lekë** në këtë zë përfshihen pagesat për “*Shpenzime për ekzekutim vendimesh gjyqësore të punonjësve të larguar nga puna*” për mos krijimin e detyrimeve te prapambetura.
- “*Materiale dhe shërbime speciale*” në vlerën **1.636.880lekë** në këtë zë përfshihen “*Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik*” përfshin prodhimin e dokumentacionit specifik që përdoret në Pikat e Kalimit Kufitar dhe nga inspektorët dhe sektorët e tjerë të DRAKU certifikata të eksportit. “*Të tjera dhe materiale dhe shërbime speciale*”.
- “*Shpenzime Mirëmbajtje të zakonshme*” në vlerën **2.096.600lekë** në këtë zë përfshihen pagesat për shpenzimet të mirëmbajtjes dhe riparime të zakonshme të AQT-ve të institucioneve të AKU-së dhe kryesisht të mjeteve të transportit , pajisjeve kompjuterike, pajisjeve laboratorike, pajisjeve te zyrave.

Në llogarinë 602 janë në proces prokurimi, procedura për blerje “Materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik”, e cila zë një përqindje të konsiderueshme në buxhetin e kësaj llogarie.

3. Realizimi i buxhetit 4-mujor në llogarinë 606 është realizuar ne masën 7% dhe vlerë 100.000 lekë. Janë kryer pagesa për buxhetet familjare si shpërblim për dalje ne pension, shpërblim për kalim sëmundje të rëndë dhe shpërblim për humbjen e të afërmeve.

4. Realizimi i buxhetit 4-mujor në llogarinë 231, në këtë zë nuk kemi realizim pasi nuk janë lidhur Kontratat për dy projektet e kësaj llogarie siq janë trajtuar dhe më lart.

- Projekti “Pajisje specifike për grupet e inspektimit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit” në vlerën 45.000.000 lekë, është procedurë e cila ndiqet nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
- Projekti “Blerje pajisje laboratorike për laboratorin të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Tiranë” në vlerën 56.155.000 lekë është procedurë e cila ndiqet nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

